



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 23.4.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË AGJENCISË
KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31
DHJETOR 2017**

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësja e Ekipit Sabile Musa dhe Anëtarët e ekipit Kreshnike Haziri, Mazlumshah Sejfadini dhe Shqiponja Krasniqi, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Faruk Rrahmani.

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|--|----|
| Përmbledhje e përgjithshme | 4 |
| 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit | 6 |
| 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm | 7 |
| 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli | 11 |
| 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve..... | 18 |
| 5 Qeverisja e mirë..... | 19 |
| Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA | 22 |
| Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake..... | 25 |
| Shtojca III: Letërkonfirmimi | 30 |

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 29/09/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Zyra Kombëtare e Auditimit e vlerëson bashkëpunimin e treguar nga menaxhmenti i lartë dhe stafi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Megjithatë, ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpenzimet për kompensimet e anëtarëve të bordit janë buxhetuar dhe shpenzuar gabimisht nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Theksimi i çështjes pasqyron dobësitë në buxhetimin dhe raportimin e shpenzimeve. Po ashtu, mangësi kishin edhe PFV-të sa i përket prezantimit të buxhetit final, shpalosjeve të pasurive dhe obligimeve.



Kryesuesi i Bordit duhet t'i analizojë arsyet për theksimin e çështjes në 2017 dhe t'i identifikoj veprimet që kërkohen për të mundësuar një prezantim të drejtë të shpenzimeve sipas kategorive ekonomike në vitin 2018. Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet prezantimit të plotë të dhënave në PFV (shih kapitullin 2).

Proceset e menaxhimit financiar ende janë të dobëta në disa fusha përfshirë menaxhimin e personelit, menaxhimin e proceseve të prokurimit, si dhe menaxhimi i pasurive (stoqeve).



Kryesuesi i Bordit duhet të aplikojë një vlerësim të detajuar të fushave për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe të përcaktoj veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet 2 - 6).

Përkundër progresit në zbatimin e rekomandimeve të viteve paraprake, një pjesë e tyre ende kanë mbetur në proces të zbatimit.



Kryesuesi i Bordit duhet ta zbatoj një proces rigoroz për të siguruar që rekomandimet e vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive ku çështjet/progreset kyçe i raportohen menaxhmentit në baza të rregullta (shih çështjen 7).

Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me azhurnimin e regjistrit të rrezikut kanë nevojë për një monitorim permanent me qëllim të adresimit dhe zvoglimit të rreziqeve.



Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që aranzhimet e Qeverisjes janë rishikuar për t'u siguruar se janë bërë ndryshime adekuate në përmirësimin e aranzhimeve të qeverisjes (shih çështjen 8).

Përgjigja e Menaxhmentit

Menaxhmenti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tutje Agjencia). Ne kemi analizuar veprimtarinë e Agjencisë, se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren e MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpenzimet për kompensime të anëtarëve të bordit në vlerë prej 375,387€ janë buxhetuar dhe shpenzuar gabimisht nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve e që do të duhej nga kategoria paga dhe mëditje. Kompensimet e anëtarëve të bordit kanë përfshirë pagesat e rregullta mujore, kompensimet tjera për mbikëqyrje, mbledhje të jashtëzakonshme dhe kompensimet si anëtarë të emëruar nëpër komitete/komisione të bordit. Buxhetimin dhe pagesën e kompensimeve nga mallrat dhe shërbimet, Agjencia e kishte e bazuar në rregulloren e tyre të brendshme për kompensimin e bordit të drejtoreve. Megjithatë kjo rregullore bie ndesh me ligjin e buxhetit për vitin 2017¹ dhe rregullën financiare 01/2013² për Shpenzimin e parave.

Si rezultat i kësaj kategoria e mallrave dhe shërbimeve është mbivlerësuar, kurse ajo e pagave e mëditjeve ishte nënvlerësuar për këtë vlerë, duke ndikuar kështu që të mos prezantohen drejtë në PFV.

Opinionin jonë nuk është modifikuar për këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Drejtori Menaxhues është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Bordi i drejtoreve dhe Drejtori Menaxhues është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Agjencisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

¹ Neni 13 paragrafi 4 - Shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve "Mallra e shërbime" nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të mëditjeve apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo dhuratat.

² Neni 33 - Organizatat buxhetore duhet të sigurojnë që të gjithë personat në marrëdhënie pune duhet të paguhen nga lista e pagave.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Agjencia kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Ligjin Nr. 05/L-063);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Planin dhe raportin përfundimtar të Prokurimit;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet tremujore duke përfshirë edhe pasqyrat nëntëmujore; dhe
- Raportet për obligimet e papaguara.

Në kontekst të PFV-ve, kemi këto çështje për të ngritur:

- *Stoqet*, në vlerë prej 39,908€ nuk ishte prezantuar në PFV;
- *Te raporti i ekzekutimit të buxhetit*, vërehet se te kolona e buxhetit final gabimisht ishte paraqitur buxheti i rishikuar, e ku diferenca ishte në vlerë prej 37,016€; dhe
- *Te shënimi 15, Raporti për detyrimet (faturat)*, dy fatura në vlerë prej 480€ edhe pse ishin pranuar ato nuk ishin prezantuar te obligimet e papaguara.

Të gjitha kërkesat për raportim të jashtëm ishin përmbushur me një cilësi të mirë dhe ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në këtë aspekt.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

- Rekomandimi 1** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes, duke ndërmarrë veprime specifike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve. Agjencia duhet të ndryshojë rregulloren e brendshme për kompensimin e drejtorëve të bordit të Agjencisë, e me pas të gjitha shpenzimet duhet të buxhetohen dhe evidentohen në përputhje me planin kontabël, bazuar në kërkesat e ligjit të buxhetit.
- Rekomandimi 2** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj prezantimin e drejtë dhe të plotë të informatave në pasqyra financiare përfshirë buxhetin final dhe shpalosjet e pasurive e detyrimeve. Gjithashtu, duhet vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj pasqyrave financiare vjetore janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi shpenzimet dhe të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, megjithatë, një sërë fushash kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Në vitin 2017, Agjencia kishte një performancë të kënaqshme buxhetore pasi që kishte shpenzuar 91% të buxhetit.

Mangësi janë identifikuar në disa procese të menaxhimit të financiar dhe kontrollit e ku si fusha më me prioritet që kërkojnë më shumë përmirësime janë: menaxhimi i personelit përfshirë tejkalimin e praktikës së menaxhimit të pozitive me ushtrues detyre, menaxhimi më i mirë i proceseve të prokurimit dhe menaxhimi i pasurive (stoqeve).

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final ³ | 2017 Realizimi | 2016 Realizimi | 2015 Realizimi |
|----------------------------|-------------------|----------------------------|------------------|------------------|------------------|
| Burimet e Fondeve: | 7,020,884 | 7,582,788 | 6,876,167 | 6,312,889 | 5,970,267 |
| Granti i Qeverisë -Buxheti | 100,000 | 661,904 | 652,960 | 9,515 | 10,572 |
| Të hyrat e Dedikuara | 6,920,884 | 6,920,884 | 6,223,207 | 6,303,374 | 5,959,695 |

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 561,904€. Fillimisht, me rishikim buxheti është rritur për 598,920€, kurse me pas me vendim⁴ të qeverisë buxheti është reduktuar për 37,016€. Rritja e buxhetit ka ndodhur si rezultat i kërkesës për Riorganizim dhe Studim të Fizibilitetit të Trepçës.

³ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

⁴ Vendimi i Qeverisë Nr. 10/19 – dhjetor 2017

Në vitin 2017, Agjencia ka shpenzuar 91% të buxhetit final ose 6,876,167€, me një përmirësim prej 3% krahasuar me vitin 2016. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale:

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final | 2017 Realizimi | 2016 Realizimi | 2015 Realizimi |
|---|-------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike: | 7,020,884 | 7,582,788 | 6,876,167 | 6,312,889 | 5,970,267 |
| Pagat dhe Mëditjet | 4,402,884 | 4,402,884 | 4,390,281 | 4,402,591 | 4,321,066 |
| Mallrat dhe Shërbimet | 2,380,000 | 2,911,904 | 2,349,683 | 1,745,292 | 1,401,519 |
| Shërbimet komunale | 98,000 | 118,000 | 80,913 | 73,594 | 84,980 |
| Subvencionet dhe Transferet | 40,000 | 50,000 | 41,379 | 78,809 | 116,003 |
| Investimet Kapitale | 100,000 | 100,000 | 13,910 | 12,603 | 46,700 |

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti për shpenzime kapitale ishte realizuar vetëm 14%. Niveli i ulët i shpenzimeve ishte rezultat që për dy projekte që përbënin 80% të vlerës kishin ndryshuar rrethanat gjatë vitit. Projekti për blerjen e veturave zyrtare në vlerë prej 75,000€ nuk ishte realizuar për faktin që Agjencia Qendrore e Prokurimit kishte iniciuar procesin e marrjes me qira të veturave në emër të të gjitha autoriteteve kontraktuese në nivel qendror dhe lokal. Kurse projekti për riparimin e ndërtesës së Agjencisë, i planifikuar për ndërrimin e objektit dhe ndryshimeve të nevojshme në të, nuk është realizuar sepse Agjencia nuk kishte arritur të ndërrojë objektin gjatë vitit 2017; dhe
- Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime për 531,904€ është rezultat i realizimit të kontratës për Riorganizimin dhe Studimin e Fizibilitetit të Trepçës. Sidoqoftë, suficiti kundrejt buxhetit të rritur në këtë kategoritë është për shkak të planifikimit joadekuat të prokurimit dhe vonesave në inicimin e kërkesave nga njësitë kërkuese.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Agjencia në 2017 ishin në vlerë 6,111,946€. Ato kanë të bëjnë me tarifën administrative 5% e të gjitha të hyrave të pranuar si rrjedhojë e çfarëdo shitje. Po ashtu, si të hyra ishin regjistruar edhe kthimet e mjeteve të telefonisë fikse si dhe kthimet tjera.

Agjencia për tejkallim të limitit të shpenzimeve të telefonisë mobile nga ana e stafit të saj gjatë vitit kishte aplikuar metodën e rimbursimit të mjeteve (cash) për vlerën e tejkallimit dhe këto mjete i deponon në llogarinë bankare dhe i regjistron si të hyra në kodin ekonomik 50019 me përshkrimin

taksa të tjera administrative. Rimbursimet e pranuar në këtë formë, as për nga natyra e as për nga qëllimi, nuk janë të hyra, mirëpo kthim i shpenzimeve të ndodhura nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

Pas trajtimit të kësaj çështje në memon e auditimit në fazën finale kemi vërejtur se Agjencia nga nëntori i vitit 2017 ka ndryshuar politikën për mbulimin e shpenzimeve të telefonisë mobile duke e kaluar të gjithë shpenzimet e telefonisë në sistemin “prepaid” e cila formë e eliminon mangësinë e theksuar më lartë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike dhe MF. Buxheti për kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve ishte 4,402,884€, ndërsa realizimi i shpenzimeve ishte 4,390,281€.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Menaxhimi i personelit

Agjencia ka Departamentin e Burimeve Njerëzore i cili është përgjegjës për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave dhe procedurave lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore.

Stafi i Agjencisë dhe statuti i saj rregullohet me ligjin për Agjencinë, ligjin e punës, ligjin për shërbimin civil, aktet nënligjore dhe dispozitat tjera ligjore në fuqi. Numri i planifikuar i stafit ishte 258, ndërsa numri aktual në dhjetor të vitit 2017 ishte 238. Agjencia ka Bordin e Drejtoreve, Drejtorin Menaxhues dhe dy Zëvendës Drejtore Menaxhues, Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive si dhe Personelin profesional dhe teknik.

Çështja 3 - Ushtrues detyre në afat më të gjatë se tre muaj

- E gjetura** Ligji për Shërbimin civil (Nr. 03/L-149), përkatësisht neni 30.4, precizon që për plotësimin e pozitës së lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës (U.D) nuk mund të emërohet më gjatë se tre muaj. Përveç dy pozitave për të cilat janë zhvilluar procedurat e rekrutimit, në Agjenci janë 15 pozita që menaxhohen me U.D. të cilët e kanë tejkaluar afatin e lejuar ligjor. Në mesin e tyre ka U.D. që nga viti 2015, dhe shumica prej tyre janë pozita udhëheqëse.
- Rreziku** Menaxhimi me ushtrues detyre përtej afateve ligjore përveç që është në kundërshtim me ligjet e aplikueshme kjo rrit edhe rrezikun që pozitën të menaxhohen nga personat që nuk i përmbushin kriteret e nevojshme. Menaxhimi i tillë ndikon që përgjegjësia dhe llogaridhënia në punë të mos jenë në nivelin e pritur duke reflektuar në performancën operationale dhe në menaxhimin jo efektiv të organizatës.
- Rekomandimi 3** Kryesuesi i bordit duhet të ndër marrë veprime shtesë për të ndërprerë mbulimin e pozitave menaxheriale me U.D. Kohëzgjatja e funksionit si U.D. të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar ligjore, pasi që ka ndikim vendimtar për funksionimin e kontrolleve dhe arritjen e objektivave.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshirë shërbimet komunale në vitin 2017 ishte 3,029,904€. Prej tyre ishin shpenzuar 2,430,596€. Ato kanë të bëjnë me shërbime kontraktuese tjera, shpenzimet e qerasë, shpenzimet për informim publik, kompensimet për anëtarët e bordit etj.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 50,000€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 41,379€. Ato kanë të bëjnë me mbështetjen e funksionit për Menaxhimin e Ndërmarrjeve Shoqërore që janë nën administrim direkt të Agjencisë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 100,000€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar vetëm 13,910€. Ato kanë të bëjnë me realizimin e një projekti për pajisje të teknologjisë informative.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.8 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 4 – Mangësi në planifikimin e prokurimit

E gjetura Për të kryer një planifikim të mirë, menaxherit të prokurimit do t'i nevojitet bashkëpunim i ngushtë me departamentin e buxhetit dhe departamentet tjera.

Bazuar në gjendjen e konstatuar duket qartë që Agjencia nuk kishte bërë planifikim të mirë të prokurimit për vitin 2017. Kjo është vërtetuar për faktin që nga 35 kontratat e realizuara 13 prej tyre nuk kishin qenë të përfshira në planin e prokurimit.

Rreziku Planifikimi i cili nuk bazohet në nevojat reale të njësive kërkuese dhe realizimi i kontratave jashtë planit të prokurimit rrisin rrezikun që projektet (blerjet) të cilat ishin të planifikuara të mbeten të porealizuara, si pasojë e devijimeve në prokurim.

Rekomandimi 4 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj një bashkëpunim efektiv në mes të njësive të cilat i procedojnë kërkesat dhe departamentit të prokurimit gjatë procesit të planifikimit. Kjo duhet të përfshijë kohën e nevojshme kur duhet të zhvillohen proceset e prokurimit e ndërlidhur me buxhetin e ndarë për Agjencinë.

Çështja 5 – Mungon plani për menaxhimin e kontratave

| | |
|----------------------|--|
| E gjetura | Në dy mostra ⁵ të prokurimit, vërejtëm që mungon plani i menaxhimit të kontratës, e cila është kërkesë e udhëzuesit operativ të prokurimit publik. |
| Rreziku | Mos përgatitja e planit të menaxhimit të kontratës rritë rrezikun që Agjencia të mos ketë kontrolle të mjaftueshme në realizimin e kontratave dhe si pasojë të shfaqen mangësi apo pengesa në realizimin e kontratave. |
| Rekomandimi 5 | Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që realizimit të kontratave duhet t'i paraprijë një plan detal për menaxhimin e kontratave me qëllim që të shmangen mangësitë në realizimin e projekteve. |

3.9 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera neto e Pasurive të Agjencisë ishte 326,445€. Prej tyre vlera e pasurive kapitale (mbi 1,000€) ishte 229,559€, pasuri jokapitale (nën 1,000€) ishin 56,978€, dhe vlera e stoqeve ishte 39,908€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullës MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, procesin e inventarizimit, zhvlerësimin dhe ekzistencën fizike të pasurive. Për të tejkaluar mangësitë në sistemin e-pasuria lidhur me zhvlerësimin e pasurive jokapitale, Agjencia ka krijuar regjistrat e veta në Excel dhe ka llogaritur zhvlerësimin në mënyrën e duhur sipas rregullës për menaxhimin e pasurive jo financiare.

Çështja 6 – Dobësi në menaxhimin dhe raportimin e stoqeve

| | |
|----------------------|--|
| E gjetura | Stoqet janë pasuri jo financiare të cilat mbahen si pajisje rezervë apo material zyre e pashpërndarë të personeli për përdorim. Agjencia për regjistrim të stoqeve aplikon sistemin e-pasuria. Sipas regjistrat nga e-pasuria gjendja e stokut në depo me 31 dhjetor të vitit 2017 ishte në vlerë 64,668€, përderisa ne verifikuam që stoku në fund të vitit ishte 39,908€ me diferencë 24,760€. Diferenca ka rrjedh si pasojë e mos azhurnimit të regjistrat. |
| Rreziku | Regjistri i stoqeve i pa azhurnuar e nënvlerëson/mbivlerëson pozicionin financiar të pasurive të organizatës dhe mund të rezultojë në atë që vendimmarrja të bëhet mbi informata të pasakta. |
| Rekomandimi 6 | Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që regjistri i stoqeve azhurnohet rregullisht, duke përfshirë evidencat e sakta për të gjitha blerjet dhe daljet e tyre në mënyrë që regjistrat e tyre të jenë të plotë dhe të saktë në çdo kohë. Evidencat e sakta të stoqeve përveç nevojave të raportimit për pasqyrat financiare vjetore ato janë të nevojshme edhe për nevojat e brendshme të menaxhmentit. |

⁵ Kontrata "Dan Graf Doo" – Shërbimet e publikimeve në një gazete në Serbi; dhe dy Kontrata – "AXA ShPK" dhe "Infocom" – Furnizim me toner për nevojat të AKP-së

3.10 Të arkëtueshmet

Vlera e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2017 ishte 2,265€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet e telefonisë fikse dhe mobile.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.11 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 62,490€, prej tyre 55,742€ ishin obligime të papaguara nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa 6,748€ për shërbime komunale. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018.

Menaxhimi dhe raportimi i obligimeve të papaguara ishte bere në përputhje me rregulloren për menaxhimin e tyre.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016 ka rezultuar me 10 rekomandime kryesore. Agjencia kishte përgatitur planin e veprimit ku kishte paraqitur afatet dhe mënyrën se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, katër rekomandime janë zbatuar, dhe gjashtë ishin në proces. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur 12 rekomandime, prej tyre në vitin 2017, gjashtë janë zbatuar dhe gjashtë janë në proces të zbatimit.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 7 - Zbatimi i rekomandimeve nga dy vitet paraprake

- E gjetura** Është evidentuar progres thelbësor në zbatimin e rekomandimeve. Megjithatë, përkundër progresit dhe angazhimit të menaxhmentit për të zbatuar rekomandimet e dhëna, një numër i tyre kanë mbete në proces të zbatimit. Rekomandimet që janë në proces të zbatimit ndërlidhen me kategorinë e pagave dhe mëditjeve, fushën e prokurimit dhe menaxhimit të pasurive.
- Rreziku** Përmirësimet e kërkuara të proceseve operacionale që nuk po zbatohen rezultojnë në përsëritjen e mangësive nga vitet paraprake dhe ndikojnë në mos efikasitet të vazhdueshëm drejt arritjes së objektivave të përcaktuara.
- Rekomandimi 7** Kryesuesi i bordit duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, po fiton ritmin e nevojshëm dhe po monitorohet në vazhdimësi në baza të rregullta në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet që kanë mbetur ende të papërfunduara, të rishikohen në një afat të shkurtër, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Disa aspekte të qeverisjes brenda AKP-së kërkojnë të përmirësohen, veçanërisht në lidhje me azhurnimin e regjistrit të rreziqeve. Përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi cilësor të auditimit të brendshëm, konsiderohen të vendosura. AKP kishte përmbushë kërkesën e MF lidhur me dorëzimin e pyetësorit të vetëvlerësimit.

Bordi i drejtoreshave është organi më i lartë i Agjencisë, përbëhet nga tetë anëtarë. Mandati i gjashtë anëtarëve të bordit ka përfunduar me 17 dhjetor 2017. Deri në përzgjedhjen e anëtarëve të bordit të ri edhe komiteti i auditimit mbetet jo funksional.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me katër anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB-së, dy auditorë dhe një zyrtar administrativ. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Planin vjetor të punës ishte hartuar në përputhje me planin strategjik, ku ishin përcaktuar disa fusha për auditim për vitin 2017.

NjAB për këtë vit ka planifikuar tetë auditime, prej të cilave gjashtë ishin finale dhe dy në proces të përfundimit. Përveç finalizimit me kohë të një numri të konsiderueshëm të raporteve ato ishin

mjaft cilësore dhe përmbajtësore. Raportet e auditimit përmbajnë konkluzione dhe rekomandime të cilat identifikojnë disa nga mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të AKP-së.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtja e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

AKP ka vendosur një sistem funksional të kontrollit të brendshëm që përfshin raportimin e rregullt tek menaxhmenti, për të mundësuar një informim me kohë dhe mundësi për përgjigje ndaj sfidave dhe problemeve të raportuara në drejtim të arritjes së objektivave. Linjat e llogaridhënies dhe të komunikimit ishin funksionale përmes raporteve dhe takimeve të rregullta.

Çështja 8 - Dobësi në menaxhimin e rrezikut

- E gjetura** Sipas rregullave të MFK-së, Agjencia ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut. Megjithatë, edhe pse regjistri i rreziqeve është hartuar, ne nuk kemi hasur dëshmi se ky regjistër është duke u menaxhuar në mënyrë aktive për sa i përket azhurnimit dhe sigurimit se janë ndërmarrë veprime për të parandaluar dhe zbutur rreziqet.
- Rreziku** Mungesa e menaxhimit efektiv dhe gjithëpërfshirës të rrezikut do të dobësojë cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve nëse çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë, nuk adresohen në kohën e duhur. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.
- Rekomandimi 8** Kryesuesi i bordit duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut nëpër sektorët përkatës dhe të sigurojë monitorim efektiv dhe raportim tremujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

| Komponenta e Auditimit | Rekomandimet e bartura nga viti 2015 | Të zbatuara gjatë vitit 2017 | Në proces të zbatimit gjatë 2017 | Të pa zbatuara |
|---|--|------------------------------|----------------------------------|----------------|
| 1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera raportim | Kryesuesi i Bordit të siguroj që janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF-ve 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçante në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF duhet të dorëzohet nëse ndaj draft PVF janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme. | Po | | |
| 2.4 Lista kontrolluese e vet-vlerësimit | Kryesuesi i Bordit të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. | Po | | |
| 2.5.1 Hartimi i objektivave strategjike | Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për vendosjen e objektivave strategjike dhe hartimin e planit strategjik. | Po | | |

| | | | | |
|--------------------------------------|---|----|---|--|
| 2.5.3 Raportimi menaxherial | Kryesuesi i Bordit të shqyrtojë shkaqet e mos aplikimit të kontrolleve në mënyre efektive dhe të sigurojë eliminimin e tyre në mënyrë që të përmirësojë dobësitë në procesin e shpenzimeve. | | Lidhur me shërbimet dhe furnizimet e pranuar nuk kemi hasur ne ndonjë çështje. Ndërsa kemi hasur në fatura të pa protokolluara. | |
| 2.5.3 Raportimi menaxherial | Kryesuesi i Bordit të sigurojë rekrutimin e stafit me kohë për të minimizuar periudhën e ushtruesit të detyrës. | | Ka filluar procesi i rekrutimit për pozitat e lira që mbahen me ushtrues detyre, megjithatë ende nuk është përfunduar. | |
| 2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm | Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm, KA duhet të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm (për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe ti ofroj sigurinë e menaxhmentit). Gjithashtu duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm. | Po | | |
| 4.3 Planifikimi i buxhetit | Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë analizuar arsyet për mosrealizimin e buxhetit dhe të përcaktojë veprimet praktike për të përmirësuar mangësitë. Për më tepër, të ketë një ndikim më të madhë në të gjithë pjesëmarrësit në planifikim të buxhetit, për të krijuar buxhetin më real financiar dhe në përputhje me objektivat e organizatës. | | Kishte ngritje në nivelin e realizimit të buxhetit, me përjashtim të investimeve kapitale me arsye të paraqitura me lartë. | |
| 4.4 Prokurimi | Kryesuesi i Bordit të sigurojë ndjekjen e procedurave në mënyrë kronologjike ashtu siç përcaktohet me kornizën rregulluese. | | Në proces, kemi hasur vonesa në realizimin e pagesave. | |
| 4.5.1 Kompensimet (pagat & mëditje) | Kryesuesi i Bordit të sigurojë që zbatim i procedurave të bëhet konform ligjit dhe rregulloreve në fuqi për shërbyesit civil. | | Kishte një proces gjyqësor, për këtë çështje. | |

| | | | | |
|--|--|-------------|---|----------------|
| 4.6 Pasuritë dhe detyrimet | Kryesuesi i Bordit të sigurojë që pasuritë regjistrohen në grupimet e pasurive sipas kriterëve për regjistrimin e tyre. | Po | | |
| 4.6.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve | Kryesuesi i Bordit duhet të forcojë nivelin e kontrolleve mbi menaxhimin e shpenzimeve të telefonisë mobile dhe të krijojë një sistem për arkëtimin e obligimeve të krijuara si rezultat i tejkalimeve të limiteve të përcaktuara. | Po | | |
| 4.6.3 Trajtimi i borxheve | Kryesuesi i Bordit duhet të inicioj një analizë për furnizimet /shërbimet e marra pa u mbuluar me kontratë dhe të sigurojë që ZKF e ka shtuar fokusin duke ofruar një sistem të besueshëm të kontrollit për shërbimet apo furnizimet e porositura. | | Ekzistojnë detyrime kontingjente për tejkalim të vlerës së kontratës, të paraqitura në PFV. | |
| Komponenta e auditimit | Rekomandimet e dhëna në vitin 2016 | Të zbatuara | Në proces të zbatimit | Të pa zbatuara |
| 1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm | Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë duke përfshirë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga drejtori Menaxhues dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme. | Po | | |
| 2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak | Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për zbatimin e planit të veprimit sipas afateve të përcaktuara, duke u fokusuar fillimisht në çështjet me të rëndësishme. | Po | | |

| | | | | |
|--|---|----|--|--|
| 2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së | Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se është rishikuar plotësimi i listës kontrolluese të vet-vlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Gjithashtu, duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. | Po | | |
| 2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes | Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprime për përcjelljen e objektivave strategjike dhe zbatimin e planit strategjik. | Po | | |
| 2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia | Kryetari i Bordit duhet të sigurojë marrjen e veprimeve të nevojshme për raportim të plotë dhe të saktë të llogarive të pagueshme dhe pagesën e tyre brenda afateve të caktuara kohore. | | Agjencia raporton në baza mujore për obligimet e papaguara, megjithatë në PFV-të e vitit 2017 nuk janë prezantuar dy fatura. | |
| 3.1.1 Pagat dhe mëditjet | Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim sistematik i dosjeve të personelit, për të siguruar përmbushjen e kërkesave në pajtueshmëri me legjislacionin e aplikueshëm, brenda një periudhe të caktuar kohore. | | Ka filluar procesi i rekrutimit për pozitat e lira që mbahen me ushtrues detyre, mirëpo nuk është përfunduar plotësisht. | |
| 3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale | Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë marrjen e veprimeve të nevojshme për planifikimin dhe realizimin më të mirë të procedurave të prokurimit në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi. | | Përkundër përmirësimeve në raport me vitin paraprak, AKP ende kishte parregullsi në planifikimin e prokurimeve. | |
| | Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për menaxhimin e duhur të kontratave nga personat përgjegjës dhe eliminimin e pagesave të parregullta. | | Ne nuk kemi hasur në pagesa të parregullta, mirëpo ende kemi vërejtur disa parregullsi në menaxhimin e kontratave. | |

| | | | | |
|---------------------------|---|--|--|--|
| 3.2 Pasuritë | Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë ndërmarr veprimet e nevojshme për regjistrimin e drejtë dhe të saktë të të gjitha pasurive dhe prezantimin në PFV. | | AKP ka krijuar regjistrat e vet në Excel për pasuritë nën 1000€, mirëpo te regjistri i stoqeve ende kemi identifikuar diferenca. | |
| 3.3 Obligimet e papaguara | Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë marrjen e veprimeve të nevojshme për të bërë pagesat e të gjitha faturave brenda afateve të caktuara kohore dhe prezantimin e të gjitha obligimeve në PVF. | | Në proces, dy fatura nuk janë prezantuar ne PFV. | |

Shtojca III: Letërkonfirmimi



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.


Ekrem HAJDARI
Drejtore Menaxhues

Data: 18 qershor 2018, Prishtinë